REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 250
Datë/Datum. 25.11.2022
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjeve Publike 'Pastrimi', bazuar në nenin 16 dhe 17 të Ligjit për Ndërmarrje Publike me Nr. 03/L-087, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin me Nr 04/L-111 dhe Ligjin me Nr. 05/L-009, në mbledhjen e mbajtur me datë 10.11.2022 ka marr vendim të shpall:

# K O N K U R S

I. **Titulli i pozitës: Anëtarë i Bordit të Drejtorëve për Ndërmarrje Publike 'Pastrimi'**
**Numri i Pozitave: 1 (një)**
**Vendi i punës: Kompania Publike 'Pastrimi'**
Mandati i anëtarit të bordit është konform Ligjit për Ndërmarrje Publike me Nr. 03/L-087, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin me Nr 04/L-111 dhe Ligjin me Nr. 05/L-009
**Kompensimi i drejtorit të bordit do të bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 20 të Ligjit për ndërmarrje publike**

## Kualifikimet dhe Përgatitja Profesionale

Sipas nenit 17, pika 17.3 të Ligjit për ndërmarrje publike, një kandidat për t'u zgjedhur anë-tar në Bordin e drejtorëve të Ndërmarrjes Publike 'Pastrimi' duhet t'i plotësojë këto kushte :

- Të jetë person që ka integritet të njohur, duke marrë parasysh, ndër tjera çfarëdo shkelje materiale të detyrave fiduciare që mund të ketë bërë ky person ndaj cilitdo person tjetër;
- Të ketë përgatitje superiore;
- Duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë së paku në një nivel të lartë të menaxhmentit në fushën e administrimit të biznesit, financave, korporatave, menaxhim i thesari, banka konsulencë në biznes ose industri ose nga një fushë tjetër e shkencave ose njohurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së; ose të ketë së paku pesë (5) vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së.

## Kushtet

Kandidati kanë të drejtë të zgjidhet në Bordin e NP-së nëse:

1. Nuk ka qenë i dënuar dhe nuk është nën hetime nga një gjykatë kompetente ;

2. Nuk ka shkelur kodin e etikës apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një gjykatë ose organi tjetër i ankesave ;

3. Nuk ka përgënjeshtrime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim ;

4. Nuk ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) viteve të fundit.

Kandidati nuk mund të zgjidhet anëtar në Bordin e NP-së nëse

1. Aktualisht është zyrtar (në kuptim të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike) menaxher i ndërmarrjes përkatëse, ose cilësdo nga filialet e saj;
2. Ka shërbyer si menaxher i ndërmarrjes publike përkatëse, ose cilësdo nga filialet e saj brenda pesë (5) viteve të kaluara;
3. Aktualisht ka ose gjatë tri (3) viteve të kaluara ka pasur çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimeve të ndërmarrjes publike) me ndërmarrjen publike përkatëse ose cilën do nga filialet, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
4. Është aksionar, drejtor ose zyrtar në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i cili ka marrëdhënie materiale afariste me ndërmarrjen publike përkatëse;
5. Pranon ose ka pranuar brenda tri (3) viteve të kaluara kompensimin shtesë nga ndërmarrja publike përkatës, ose nga cila do filiale e saj (përveç honorarit të drejtorit ose kompensimin stimulues të përcaktuar me nenin 20 të Ligjit për Ndërmarrje Publike, ose është anëtar në skemën pensionale të ndërmarrjes publike ose të cilës do filialat e saja;
6. Përfaqëson një aksionar i cili posedon mbi dhjetë (10%) të aksioneve votuese në ndërmarrjen publike përkatës;
7. Ka shërbyer në Bordin e drejtorëve të ndërmarrjes publike përkatëse, më shumë se nëntë (9) vite nga data e parë e zgjedhjes së tij;
8. Është i afërt i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e interesit financiar në nenin 2 të Ligjit për Ndërmarrje Publike) i cilit do person që i takon cilës do nga kategoritë e sipërpërmendura;
9. Është zyrtar, drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkurron me ndërmarrjen, ose është një menaxher i lartë zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë e dy përqind (2 %) të të drejtave të votimit), ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare që konkurrojnë në ndërmarrjen;
10. Është, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) mujore para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;

11. Ka çfarëdo konflikti të interesit që për nga natyra, do të shkaktonte që ky përson të mos jetë në gjendje që në mënyrë efektive, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij përgjegjës ndaj aksionarëve dhe ndërmarrjes publike .

Procedura e Konkurrimit

Kandidatët për anëtar të Drejtorëve të NP, duhet t'i dorëzoj provat e mëposhtme

- CV-në
- Letër motivimi
- Deklaratën nën Betim
- Dëshminë mbi përvojën e punës
- Certifikatën që nuk është nën hetime nga Gjykata Kompetente
- Kopjen e Letërnjoftimit

Aplikuesi duhet të plotësoj deklaratën nën betim, me të cilën deklaron se i përmbushë kushtet e kualifikimit pavarësisht nga përgatitja profesionale. Ç'do përgënjeshtrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshimi material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërme përmendura, do të rezultojë me diskualifikimin e menjëhershëm
Data e shpalljes së Konkursit nga: data 25.11.2022 deri me data 24.12.2022.

Aplikantët e interesuar kërkesën për aplikim me dokumentacionet përcjellëse duhet ti dorëzojnë në zyrën e arkivit të komunës së Fushë-Kosovës nga data 25.11.2022 deri me datë 24.12.2022, çdo ditë pune nga ora 9 deri në orën 15h
Aplikacioni dhe deklarata nën betim mund të shkarkohet në ueb-faqen e komunës së Fushë-Kosovës, ose mund të mirren fizikisht në zyrën e arkivit të komunës.
Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike nga data e publikimit.

**Kryesuesi i Aksionarëve**
**Laureat Gojnovci**

_______________

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

# APLIKACION PËR PUNËSIM

**Ju lutem lexoni me kujdes dhe përgjigjuni qartë në çdo pyetje.**

| **1. Pozita/at në të cilën/at aplikoni** | 1) |
|---|---|
| | 2) |
| | 3) |

**2. TË DHËNAT PERSONALE**

| a. Emri | Emri i prindit | Mbiemri | Mbiemri i vajzërisë (nëse ka) | Gjinia: ☐ M ☐ F |
|---|---|---|---|---|

| b. Data dhe vendi i lindjes | Shtetësia | Kombësia | Adresa e vendbanimit | Statusi martesor | Nr. tel:<br>E-mail: |
|---|---|---|---|---|---|

| c. A është ndonjë nga familjarët tuaj i punësuar në N.P. Pastrimi . (nëse "po" plotësoni të dhënat):<br>☐ Jo ☐ Po | Emri Mbiemri | Lidhja familjare |
|---|---|---|
| | | |
| | | |
| | | |

**3. NJOHJA E GJUHËVE?** Gjuha amtare e juaja:
***(vërejtje: katrorët më poshtë të plotësohen me shenjën "X")***

| GJUHËT TJERA | *LEXOJ* | | *SHKRUAJ* | | *FLAS* | | *KUPTOJ* | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Rrjedhsh-ëm | Jo rrjedh-shëm | Rrjedhsh-ëm | Jo rrjedhshëm | Rrjedhsh-ëm | Jo rrjedhshëm | Lehtë | Jo lehtë |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |

**4. EDUKIMI,** shënoni të dhënat e plota

a. **Universiteti apo edukim tjetër formal**

| Emri i institucionit shkollor dhe vendi | Prej/Deri Muaji/Viti | Titulli i fituar | Drejtimi | Diploma |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

| b. **Trajnime apo aftësime tjera profesionale** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Emri i institucionit shkollor dhe vendi | Lloji i trajnimit apo edukimit tjetër | Vitet e vijuara | | Certifikatat apo Diplomat | Vërejtje |
| | | Prej | Deri | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

| **5. SHKATHTËSITË** | |
|---|---|
| a. Aftësitë kompjuterike *(klikoni në fushën brenda katrorit)*<br>MS Word ☐ MS Excel ☐ MS PowerPoint ☐ Tjera *(specifikoni)* | b. A posedoni patentë shofer?<br>☐ Jo ☐ Po |
| b. Aftësi tjera: | |

| **6. TË DHËNAT MBI PUNËSIMIN** | | |
|---|---|---|
| Ju lutem plotësoni të dhënat në vazhdim duke filluar me punësimin tuaj aktual apo të fundit | | |
| a. Emri i punëdhënësit | Emri Mbiemri i mbikëqyrësit | Datat e punësimit |
| | | Prej<br>Deri |
| | Titulli i pozitës tuaj | |
| Arsyeja e largimit | | |
| Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive, etj. | | |
| | | |
| b. Emri i punëdhënësit | Emri Mbiemri i mbikëqyrësit | Datat e punësimit |
| | | Prej<br>Deri |
| | Titulli i pozitës tuaj | |
| Arsyeja e largimit | | |
| Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive, etj. | | |
| | | |

| c. Emri i punëdhënësit | Emri Mbiemri i mbikëqyrësit | Datat e punësimit |
|---|---|---|
| | | Prej<br>Deri |
| | Titulli i pozitës tuaj | |
| Arsyeja e largimit | | |
| Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive, etj. | | |
| | | |

| d. Emri i punëdhënësit | Emri Mbiemri i mbikëqyrësit | Datat e punësimit |
|---|---|---|
| | | Prej<br>Deri |
| | Titulli i pozitës tuaj | |
| Arsyeja e largimit | | |
| Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive, etj. | | |
| | | |

| e. Emri i punëdhënësit | Emri Mbiemri i mbikëqyrësit | Datat e punësimit |
|---|---|---|
| | | Prej<br>Deri |
| | Titulli i pozitës tuaj | |
| Arsyeja e largimit | | |
| Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive, etj. | | |

**7. REFERENCAT**

Shënoni tre persona, jo të afërmit e juaj të cilët kanë njohuri për personalitetin dhe kualifikimin tuaj. *Mos përsëritni emrat e mbikëqyrësve të paraqitur në pjesën "TË DHËNAT PËR PUNËSIM"*

| Emri Mbiemri | Numri i telefonit | Profesioni | Adresa e plotë |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**8. INFORMATA SHTESË**

a. Ju lutem shënoni ndonjë aftësi tjera apo fakte tjera relevante që do të merreshin parasysh lidhur me aplikimin tuaj

b. A mund të kontaktojmë punëdhënësin tuaj aktual? ☐ Jo ☐ Po

**9. A KENI QENË NDONJËHERË I ARRESTUAR, I AKUZUAR APO I GJYKUAR NË NDONJË ÇËSHTJE GJYQËSORE?**

☐ Jo ☐ Po

Nëse "Po", paraqitni detajet e secilit rast në një deklaratë të bashkangjitur

**10. Deklaroj se të gjitha të dhënat e ofruara në këtë aplikacion janë të sakta, të plota dhe korrekte. Për çdo të dhënë dhe dokumente tjera të ofruara jo të sakta do të bartë përgjegjësinë deri në shkëputje apo shkarkim nga puna.**

**Data :** **Nr. i letërnjoftimit:** **Nënshkrimi :**

.

# DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i nënshkruari, (*Emri, Mbiemri*)____________________________, i lindur më (*data e lindjes*)______________, në (*vendi i lindjes*)____________________, deklaroj dhe solemnisht me nënshkrimin e kësaj deklarate betohem se i plotësoj kushtet për emërimin në pozitën ______________________________ të Ndërmarrjes Publike "Pastrimi" (i) i plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) i plotësoj kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) (iii) nuk jam, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kam qenë Drejtorë të Bordit të kompanisë gjegjëse dhe (iv) kam përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë, siç është përcaktuar në Ligjin për ndërmarrje publike *[Ligji mbi Ndërmarrjet Publike, Nr. 03/L-087, ndryshim plotësimin e Ligjit për NP Ligji Nr.04/L-111, ndryshim plotësimin e Ligjit për NP Ligji nr. 05/L -009].*

Çdo përgënjeshtrim material – qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca – ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërcekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm dhe nëse është e aplikueshme, largimin e personit.

Emri, mbiemri ____________________ Nënshkrimi____________________

Vendi: __________________________ Datë: ____/____/____________

**VËREJTJE:** Kjo Deklaratë dhe ky Betim nuk konstituon asnjë lloj marrëdhënie të çfarëdollojshme ndërmjet kandidatit dhe Ndërmarrjës Publike "Pastrimi", dhe si e tillë trajtohet si e veçantë dhe pavarur në raport me çfarëdo kontesti apo kundërthënie.